34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parcalizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimit dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Forcë Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e ulyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i fuqës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHIJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **OB614-25-6338-5-2-1/C579**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <u>[gjuha e procedurës - Shqipe]</u> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës OE, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit me afat të vlefshmërisë prej +30 ditë nga skadimi i kontratës Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në PJESA IV E KONTRATËS
	11.2	Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit: (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit		
Fillimi i punëve	17.1	Kontraktuesi do të filloj punët brenda 5 dite nga nënshkrimi i kontratës. *Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, Kontrata hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të palëve dhe si ditë zyrtare për fillim të punimeve do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Nëse Ofruesi i punëve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa kryera deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të porosisë.. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim dhe do të jetë përgjegjës për mos futje në penale.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365ditë ose 1vite Po ashtu për sigurimin e cilësisë së punëve, Operatori Ekonomik pas pranimit teknik duhet të ofrojë garancion bankar për sigurimin e punëve 10 % nga vlera e kontratës, në kohëzgjatje 3 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do të sanohet në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do të sanohet me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të faturonjë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Nëse janë grup OE, kjo deklaratë jepet në emër të liderit të konzorciumit
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet që të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Projekt menaxheri i kontratës, personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues, Zyrtarin përgjegjës të prokurimit si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga Kryesi i shërbimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Projekti i kryesor i Kanalltës në Breznice, rruges Daut Hashani në Obiliq, rruges të Sekiraoet në Mazgjit rruges Dardania Seg I në Milloshevc dhe ndërtimi i këndeve të lojërave afër fushave sportive në Dardhishtë

Vërejtje: Para përdorimit të materialeve si Zhavorit, gypave dhe elementeve tjera përbërëse, Operatori Shërbyes është i obliguar që të sjellë atestet. Pas formimit të bazës së rrugës Operatori duhet të sjellë edhe vlerat e modulit të ngjeshmërisë para se të hedhë asfaltin në vepër. Në çmim duhet të kalkulohet blerja, furnizimi si dhe punimi i të gjitha materialeve të cekura në këtë paramasë. Gjatë punimeve duhet të vendoset sinjalizim për siguri në vendpunishte.

1 MAZGJIT RRUGA TË SEKIRAOET L=310m B=3-5m					
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	PUNËT PËRGADITORE				
1.1	Të bëhet inçizimi gjeodezik i trasesë, të bëhet pikëtimi dhe të nxirren dimensionet e rrugës në bazë të matjeve të cilat i siguronin nga terreni.	m'	310	35.00€	10,850.00 €
1.2	prerja e asfaltit në formë të rregullta gjeometrike në ato pjesë ku do të intervenohet, gërryeja e një shtrese të hollë të asfaltit dhe përgaditja e tij për aplikimin e shtresës finale të asfaltit si dhe transporti i materialit deri në depot	m²	1125	0.70€	787.50 €
NËNTOTALI:					11,637.50 €
2	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS				
2.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 15cm në gjendje të ngjeshur. Ngjeshja duhet të arrijë koeficientin >60 MN/m². Të bëhet vetëm në pjesët ku ka nevojë të sanimit të strukturës së rrugës	m³	29.25	5.00€	146.25 €
2.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit për mbushjen e Bankinave (fraksion Ø 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 10cm pas ngjeshjes.	m³	15.50	5.00€	77.50 €
NËNTOTALI:					223.75 €
3	PUNËT E NGRITJES SË PUSËTAVE				
3.1	Gjatë punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusëtave egzistuese, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusëtat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusëtë dhe ngritja e pusëtës duhet të bëhet në mënyrë precize për të qenë në nivel të njëjtë me asfalt.	Copë	1.00	21.20	21.20 €
3.2	Kapaku i Pusëtës duhet të furnizohet dhe montohet nga materiali i grësës 40Ton.	Copë	1.00	85.00	85.00 €
NËNTOTALI:					106.20 €
4	PUNËT E ASFALTIT				

4.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e Asfalt Betonit AB 11, me trashësi t= 5 cm në gjendje të ngjeshur, sasia e perberjes së bituminit duhet të jetë e mjaftueshme sipas normave në menyrë që asfalti të jetë mirë i lidhur dhe jo poroz. Në momentin e hudhjes në vepër dhe gjatë fazës fillestare të ngjeshjes materiali duhet ta ketë temperaturën mbi 130°C. Vërejtje: Punëkryesi është i obliguar që gjatë vendosjes së asfaltit të kujdeset që vijat anësore të asfaltit të mbesin të drejta si dhe pjerrtësia e kerkuar në detyrën projektuese të respektohet. Ngjeshja e asfaltit duhet të bëhet në distanca të caktuara sipas Menaxherit të Kontratës	m ²	1,125.00	4.50€	5,062.50 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e Asfalt Binderit BA22, me trashësi t= 8 cm në gjendje të ngjeshur, sasia e perberjes së bituminit duhet të jetë e mjaftueshme sipas normave në menyrë që asfalti të jetë mirë i lidhur dhe jo poroz. Në momentin e hudhjes në vepër dhe gjatë fazës fillestare të ngjeshjes materiali duhet ta ketë temperaturën mbi 130°C. Vërejtje: Punëkryesi është i obliguar që gjatë vendosjes së asfaltit të kujdeset që vijat anësore të asfaltit të mbesin të drejta si dhe pjerrtësia e kerkuar në detyrën projektuese të respektohet. Ngjeshja e asfaltit duhet të bëhet në distanca të caktuara sipas Menaxherit të Kontratës. Te behet vetem ne pjeset ku ka nevoj te sanimit te struktures se rruges si dhe lyerja me emulusion ne ato pjese ku eshte bere prerja e asfaltit .	m ²	195.00	6.00€	1,170.00 €
4.3	Furnizimi me emuluzion dhe sperkatja e komplet sipërfaqes ku do te shtrohet shtresa e dyte e asfaltit	m ²	1,125.00	0.20€	225.00 €
4.4	OSh është obligativ pas përfundimit të Asfaltimit me të cilin do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës (atesti marshall) i Asfaltit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	Copë	3.00	35.00€	105.00 €

NËNTOTALI: 6,562.50 €

REKAPITULIMI I RRUGËS

1	PUNËT PËRGADITORE	11,637.50 €
2	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS	223.75 €
3	PUNËT E NGRITJES SË PUSHTAVE	106.20 €
4	PUNËT E ASFALTIT	6,562.50 €
TOTALI		18,529.95 €

II A MILLOSHEVË RR.DARDANIA SEG.1 L=30m, B=4m					
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
I	PUNËT PËRGADITORE				
1.1	Të bëhet inçizimi gjeodezik i trasesë, të bëhet pikëtimi dhe të nxirren kuotat e rrugës në bazë të matjeve të cilat i siguron nga terreni.	m'	80.00	35.00€	2,800.00 €

					NËNTOTALI:	2,800.00 €
II.	PUNËT TOKËSORE					
2.1	Gërmimi i shtresës së perzier zhavor/humus dhe material shkëmbor deri në arritjen e nivelit të kërkuar, pra heqja e shtresës së tokës deri te pjesa e fortë dhe të përgaditet për bazament të rrugës. Materiali i germuar duhet të transportohet deri në deponi në rreze përafërsisht 5km, sipas udhëzimeve të menaxherit të kontratës.	m ³	164.80	3.50€		576.80 €
2.2	Pas të gjitha procedurave të gryerjeve dhe planifikimit, do të thot kur të formohet traseja e rrugës duhet të ngjeshet toka në nivel të duhur, para se të fillohet të punohet me zhavor.	m'	92.00	1.00€		92.00 €
2.3	Furnizimi me xheotekstil(300g/m2) dhe shtruarja në tërë sipërfaqen e rrugës.	m ²	412.00	1.50€		618.00 €
2.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-16mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 5cm në gjendje të ngjeshur. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa për të bërë materialin kompakt. .Dim 95x 4x 0.05m.	m ³	20.60	5.00€		103.00 €
					NËNTOTALI:	1,389.80 €
III.	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS					
3.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-60mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 20cm në gjendje të ngjeshur. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa. Dim 95x 4x 0.20m	m ³	82.40	5.00€		412.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 10cm në gjendje të ngjeshur. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, Ngjeshja duhet të arrijë koficientin 60 MN/m2. Dim 95x 4x 0.10m	m ³	41.20	5.00€		206.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit për mbushjen e Bankinave (fraksion Ø 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 8cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet dhe të formohen bankinat. Dim (95x 0.50 x 0.08) x 2	m ³	6.40	5.00€		32.00 €
3.5	Operatori Shërbyes është obligativ për zhavorin me të cili do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës Atesti, Para asfaltimit duhet të dorëzohet raporti i modulit të ngjeshmërisë, dhe duhet të bëhet matja e trashësisë së zhavorit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	Copë	2.00	35.00€		70.00 €
					NËNTOTALI:	720.00 €
IV	PUNËT E PUSETAVE					

4.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusetave egzistuese, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusetat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusetë dhe ngritja e pusetës duhet të bëhet në mënyrë precize për të qenë në nivel të njëjtë me asfalt.	Copë	1.00	50.00	50.00€
4.2	Furnizimi dhe montimi I kapakut të Pusetës duhet të furnizohet dhe montohet nga materiali i gizës ose I plastifikuar me peshë mbajëse 40Ton	Copë	1.00	90.00	90.00€
4.3	Furnizimi transporti dhe montimi I konit 800/600mm	Copë	1	20	20.00€
NËNTOTALI:					160.00€
V	PUNËT E ASFALTIT				
5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja Asfalt Betonit(AB) me fraksion të agregatit Ø 0-16mm, me trashësi t= 8 cm në gjendje të ngjeshur, sasia e perberjes së bituminit duhet të jetë e mjaftueshme sipas normave në mënyrë që asfalti të jetë mirë i lidhur dhe jo poroz. Në momentin e hüdhes në vepër dhe gjatë fazës fillestare të ngjeshjes materiali duhet ta ketë temperaturën mbi 130°C. Vërejtje: Punëkryesi është i obliguar që gjatë vendosjes së asfaltit të kujdeset që vijat anësore të asfaltit të mbesin të drejta si dhe pjerrtësia e kerkuar në detyrën projektuese të respektohet. Ngjeshja e asfaltit duhet të bëhet në distanca të caktuara sipas Menaxherit të Kontratës sa duhet të jte cilindri në mesë Finisherit të Asfaltit. Dim: 95x3m	m²	335.00	6.00€	2,010.00 €
	Janë të kalkuluar në sasi të asfaltit 12 m² për zgjerim në hyrje të rrugës.				
5.2	OSh është obligativ pas përfundimit të Asfaltimit me të cilin do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës (atesti marshall) i Asfaltit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	Copë	2.00	35.00€	70.00 €
NËNTOTALI:					2,080.00 €
II	REKAPITULIMI I RRUGËS Dardania SEG.1				
1	PUNËT PËRGADITORE				2,800.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				1,389.80 €
3	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS				720.00 €
4	PUNËT E PUSETAVE				160.00 €
5	PUNËT E ASFALTIT				2,080.00 €
TOTALI:					7,149.80 €
II B	MIL LOSHEVË RR.DARDANIA SEG TE VOGLA				
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
I	PUNËT PËRGADITORE				
	Vërejtje: Para përdorimit të materialeve si Zhavorit, gypave dhe elementeve tjera përbërëse, Operatori Shërbyes është i obliguar që të sjellë atestet paraprake për prejardhjen e materialit.				

1.1	Të bëhet inçizimi gjeodezik i trasesë, të bëhet pikëtimi dhe të nxirren kuotat dhe profilet e rrugës në bazë të matjeve të cilat i siguron nga terreni.	m'	70.00	35.00€	2,450.00 €
NËNTOTALI: 1					2,450.00 €
II.	PUNËT TOKËSORE				
	Gjatë punëve në gjërmim të trasesë, duhet të ketë kujdes të shtuar për shkak të instalimeve nëntokësore.				
2.1	Gjermimi I shtresës së perzier zhavor/humus deri në arrijen e nivelit të kërkuar, pra heqja e shtresës së tokës deri te pjesa e fortë dhe të përgaditet për bazament të rrugës , bartja dhe transporti i materialit deri ne deponi. Gjermimi i terrenit duhet të bëhet L= 70 m; B mes=5m; H=0.40m	m ³	140.00	1.00€	140.00 €
NËNTOTALI: 2					140.00 €
III.	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS				
3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-60mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 20cm në gjendje të ngjeshur. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, çdo shtresë duhet të ujitet, për të bërë materialin kompakt. Dim 70 x 5.0x 0.20m	m ³	70.00	5.00€	350.00 €
3.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 10cm në gjendje të ngjeshur. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, çdo shtresë duhet të ujitet, për të bërë materialin kompakt. Ngjeshja duhet të arrijë koficientin 60 MN/m2. Dim 70 x 5.0 x 0.10m	m ³	35.00	5.00€	175.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gurit të bluar Ø 4-8mm me trashësi mesatarishtë 5cm, për vendosjen e kubzave.	m ³	16.80	5.00€	84.00 €
3.5	Operatori Shërbyes është obligativ për zhavorin me të cili do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës Atesti, Para vendosjes së kupzave duhet të dorëzohet raporti i modulit të ngjeshmërisë, dhe duhet të bëhet matja e trashësisë së zhavorit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	Copë	2.00	25.00€	50.00 €
NËNTOTALI: 3					659.00 €
IV	PUNËT E NGRITJES SË PUSËTAVE				
4.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusëtave të kanalizimit, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusetat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusetë dhe ngritja e pusëtës duhet të bëhet në mënyrë precize dhe të jetë e nivelizuar me rrugë.	Copë	3.00	20.00€	60.00 €
4.2	Furnizimi dhe montimi i kapakut të Pusëtës duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i gizës mbi 40Ton.	Copë	3.00	120.00€	360.00 €
NËNTOTALI:4					420.00 €

V	PUNËT E KUBËZAVE				
5.1	Furnizimi,transporti dhe montimi i skajorëve nga betoni C35/45MPa me dim.18 x 24 x 100 cm për kufizimin e rrugës. Skajorët duhet të montohen në vijë të drejtë, fugat,duhet të mbushen dhe të jenë të nivelizuara me skajorë si dhe te parashihet edhe betonimi i skajoreve per montimin e tyre.	m'	70.00	6.00€	420.00 €
5.3	Furnizimi dhe transporti i kubëzave të parafabrikuara nga betoni C35/45, me trashësi t=8cm, formen e kubzave e cakton menaxheri I kontratës.Janë të kalkuluara në sasi të kubëzave 20 m2 për zgjerim në hyrje të rrugës.	m²	336.00	5.00€	1,680.00 €
5.4	Planifikimi dhe montimi i kubzave në rrugë. Në këtë pozicion duhet të llogaritet ngjeshja edhe mbushja e fugave.	m²	336.00	3.00€	1,008.00 €
NËNTOTALI: 5					3,108.00 €
REKAPITULIMI I SEGMENTEVE					
I	PUNËT PËRGADITORE				2,450.00 €
II	PUNËT TOKËSORE				140.00 €
III	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS				659.00 €
IV	PUNËT E NGRITJES SË PUSHTAVE				420.00 €
V	PUNËT E KUBËZAVE				3,108.00 €
TOTALI					6,777.00 €
REKAPITULIMI I SEGMENTEVE RRUGA DARDANIA					
A	MILLOSHEVË RR.DARDANIA SEG.1 L=80m, B=4m				7,149.80 €
B	MILLOSHEVË RR.DARDANIA SEG TE VOGLA				6,777.00 €
TOTALI					13,926.80 €

III PUNËT E INFRASTRUKTURËS RRUGA DAUT HASHANI					
1 Punët e Përgatitjes së Punishtes					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.1	Shenimi i trasesë para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit (Sipas Projektit).	m'	211.00	€ 35.00	€ 7,385.00
1.2	Egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh tamponit, pllakave, skajoreve dhe elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përrardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	m'	211.00	€ 1.00	€ 211.00
TOTAL POZICIONI				1	€ 7,596.00

2 Punët e Demolimit					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
2.1	Gërryerja e shtresës ekzistuese të asfaltit sipas udhëzimeve nga projekti dhe të organit mbikqyrës të punishtës. Trashësia e gërryerjes duhet të jetë t=5 cm. Materiali i grumbulluar duhet të largohet në një vend të caktuar sipas udhëzimeve të organit mbikqyrës në largësi deri 15 km prej punishtes.	m ²	380.00	€ 1.00	€ 380.00
2.2	Demolimi i shenjave të komunikacionit, ruajtja e tyre dhe rivendosja në vendet paraprake.	copë	4.00	€ 35.00	€ 140.00
Nëntotali				2	€ 520.00

3 Punët foksore dhe tamponit					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
3.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me thellësi sipas prerjeve terthore në projekt, për segmentet ku duhet të ndertohet i gjithë konstruksioni i rruges, përfshirë ngarkimin dhe bartjen në deponi në largësi deri në 15km.	m ³	795.00	€ 1.00	€ 795.00
3.2	Planifikimi, nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës me cilindër deri në modul deformimi $M_v=30\text{MN/m}^2$, për segmentet ku duhet të ndertohet i gjithë konstruksioni i rruges.	m ²	1160.00	€ 0.05	€ 58.00
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme të materialit mbushës - fraksion 0-120mm me trashësi të shtresës d=40cm (në gjendje të ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj	m ³	496.00	€ 3.00	€ 1,488.00
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme të Tamponit - fraksion 0-63mm me trashësi të shtresës d=25cm (në gjendje të ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ($M_t \geq 70\text{MN/m}^2$).	m ³	312.00	€ 5.00	€ 1,560.00

3.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme të Tamponit - fraksion 0-31,5mm me trashësi të shtresës d=10cm (në gjendje të ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt≥80Mn/m2).	m ³	124.00	€ 5.00	€ 620.00
Nentotali			3	€	4,521.00

4	Punët e Asfaltit				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltbetonit nga materiali i njëtrajtshëm Ab16 me trashësi t=80mm në shiritin e qarkullimit të automjeteve duke përfshirë lyerjen me emulsion 0,80kg/m2.	m ²	1095.00	€ 6.00	€ 6,570.00
Nentotali			4	€	6,570.00

5	Punët e ngritjes së pusetave				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
5.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusetave egzistuese, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusetat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusetë dhe ngritja e pusetës duhet të bëhet në mënyrë precize për të qenë në nivel të njejtë me asfalt.	Copë	3	50.00	150.00€
5.2	Furnizimi dhe montimi i kapakut të Pusetës duhet të furnizohet dhe montohet nga materiali i gizës ose i plastifikuar me peshë mbajtëse 40Ton	Copë	3	90.00	270.00€
5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i konit 800/600mm	Copë	3	20	60.00€
Nentotali			5	€	480.00

6	Sinjalizimi Vertikal				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
6.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë trekëndëshe me gjatësi të brinjës së trekëndëshit barabrinjës prej 900 mm.	copë	2.00	€ 90.00	€ 180.00
6.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë rrethore përfshirë dhe shenjen STOP me diametër 600 mm.	copë	4.00	€ 90.00	€ 360.00
6.3	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkendore të informimit me dimensione 600x600mm	copë	4.00	€ 90.00	€ 360.00
Verejtje: Foliet e sipërfaqeve retroreflektuese të shenjave të trafikut duhet të punohen së paku të shkallës së dytë retro-reflektuese të tipit Diamong Grade - DG.					
Nentotali			6	€	900.00

7	Sinjalizimi horizontal				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
7.1	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave te bardha te plota (gjerësia 150 mm)	m'	462.00	€ 0.30	€ 138.60
7.2	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave te bardha terthore (te plota) te ndalimit (gjerësia 500 mm)	m'	8.00	€ 0.30	€ 2.40
7.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija te bardha te nderprera (3+3+3 m, me gjersi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	115.00	€ 0.30	€ 34.50
7.4	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija te bardha te nderprera (1+1+1 m, me gjersi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	20.00	€ 0.30	€ 6.00
7.5	Furnizimi dhe punimi në rrugë për shenjimin e vendkalimit te kembesoreve (pjesa e ngjyrosur e rruges)	m ²	20.00	€ 5.00	€ 100.00
7.6	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave terthore te bardha te ndërprera, para vendkalimit të këmbësorëve (0.5+0.5 m, me gjersi 0.25 m)	m'	10.00	€ 3.00	€ 30.00
7.7	Furnizimi dhe punimi ne rrugë me shigjeta për lëvizje (me gjatesi 5.00 m)	copë	4.00	€ 40.00	€ 160.00
	Vërejtje: Ngjyra duhet të jetë mase plastike e ftohtë dy komponenteshe (termoplastike) me rruaza qelqi dhe agregate kunder rreshqitjes, me trashesi te ngjyres ne siperfaqe mbi 3 mm, me koeficient te ndriçimit te retrorefleksionit gjatë natës (thate) i klasit min R3≥150 mcd, ne lagështi Rë3 35 mcd, koeficient te ndriçimit gjatë dites min. B3, β ≥0.4, koeficient te ndriçimit në ndriçimin difuz Q2≥100 sipas IS EN 1436, rezistenca ndaj rreshqitjes klasit S2≥50. Ngjyra duhet ta kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit UNE – EN 1436:2009 + A1:2009. Ky specifikacion vlen për të gjitha pozicionet e mësiperme të sinjalizimit horizontal të rrugës.				
		Nentotali		7 €	471.50

REKAPITULLIM		
1	Punët e Pergatitjes se Punishtes	€ 7,596.00
2	Punët e Demolimit	€ 520.00
3	Punët toksore dhe tamponit	€ 4,521.00
4	Punët e Asfaltit	€ 6,570.00
5	Punët e ngritjes se pusetave	€ 480.00
6	Sinjalizimi Vertikal	€ 900.00
7	Sinjalizimi horizontal	€ 471.50
PUNËT E INFRASTRUKTURËS RRUGA DAUT HASHANI		GJITHSEJT € 21,058.50

IV HARTIMI I PROJEKTIT KRYESOR "NDËRTIMI I KANALETËS PËR 'RR.SHAHIQI' NË LAGJEN BEQUKU NË BREZNICË"					
1 PUNËT PARAPREGADITORE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.01	Shenimi i trasesë para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit (Sipas Projektit).	m'	570.00	€ 35.00	€ 19,950.00
1.02	Pastrimi i terrenit dhe prerja e shkurreve dhe drunjëve pergjatë rrugës, dhe largimi i tyre deri në deponi ne largesi deri 15km.	m'	570.00	€ 0.50	€ 285.00
1.03	Hapja e rruges per punimin e kanaleve, mbushja me zhavor per qarkullim dhe kthimi i terenit ne gjendjen parparake pas perfudnimit te punimeve	m'	570.00	€ 0.50	€ 285.00
Nentotali				1 €	20,520.00

2 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
2.01	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me thellësi sipas projektit, përfshirë ngarkimin dhe bartjen në deponi në largësi deri ne 15km.	m³	675.00	€ 1.00	€ 675.00
2.02	Planifikimi, nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës me cilindër për të gjithë gjatësinë e kanalit dhe me gjerësi prej 1,00 m deri në modul deformimi Mv=30MN/m2.	m²	1,350.00	€ 0.05	€ 67.50
Nentotali				2 €	742.50

3 PUNËT E BETONIT DHE ARMATURËS					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	VËREJTJE 1: Punëkryesi është i obliguar që të merr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat. VËREJTJE 2: Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuar si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivët e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit				
3.01	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i kanalit me dimensione si ne detajet e projektit. Betonimi të bëhet me beton të markës C-20/25 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m³	146.00	€ 65.00	€ 9,490.00
3.02	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korrozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.	kg	6,313.00	€ 0.80	€ 5,050.40
Nentotali				3 €	14,540.40

4 PUNËT E NDRYSHME					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA

4.01	Furnizimi me material dhe punimi i materialit hidroizolues elastik per mbylljen e fugave te delatimit me trashesi t=1,5cm	m'	380.00	€	0.50	€	190.00
4.02	Furnizimi dhe punimi i gypave Ø 500mm ne betoni i armuar per punimin e kalimeve te kanalit. Ne kete pozicion te llogaritet edhe lidhja e gypit me kanal, si dhe furnizimi dhe mbushja rreth gypit me material nga guri I thyer 0-63mm.	m'	25.00	€	20.00	€	500.00
Nentotali					4	€	690.00

REKAPITULLIM							
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE			€			20,520.00
1.02	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT			€			742.50
1.03	PUNËT E BETONIT DHE ARMATURËS			€			14,540.40
1.04	PUNËT E NDRYSHME			€			690.00
HARTIMI I PROJEKTIT KRYESOR "NDËRTIMI I KANALETËS PËR 'RR.SHAHIQI' NË LAGJEN BEQUKU NË BREZNICË"				GJITHSEJT	€		36,492.90

IV	Ndërtimi i këndeve të lojrave afër fushave sportive në Dardhishtë
VËREJTJE:	
Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me çertifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit	

ARKITEKTURA					
PARKU 1					
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.01.01	Pergaditja e hapsires, geryerja e terenit dhe rrafshimi i shtreses se humusit duke perfshire pregaditjen dhe me makineri perkatese per fillimin e punimeve. Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve. Ne cmim perfshihet dhe pozicionimi i parkut ne koordinim me menaxherin e kontrates	komplet	1	100.00 €	100.00 €
TOTAL POZICIONI				1.01	100.00 €

1.02	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.02.01	Të behet gërmimi i shtresës së humusit me makineri dhe me dorë me thellësi min.25 cm (kuota -0.25) në tërë sipërfaqen e parkut ku do të punohet me ansore te betonit si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 20 km distance.	m ²	90.00	3.50 €	315.00 €

